Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përfaqësuar me autorizim të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. _____ prot., datë_____, nga z/znj._____, me detyrë _____ në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, i datëlindjes _____, banues në _____, me shtetësi shqiptare i pajisur me kartën e identitetit me nr. personal _____, që më poshtë do të quhet "QIRADHËNËSI"

DHE

Subjekti "CEREN Ismet Shehu" SHPK, me seli qendrore në Tiranë, me adresë, Surrel- Njësia Administrative Dajt Tiranë, regjistruar si person juridik dhe pajisur nga Q.K.B me NIPT L 92215034 U, përfaqësuar nga administratori i shoqërisë_____, e datëlindjes ___/___/_____, lindur në _____ dhe banuese në _____, me shtetësi shqiptare, identifikuar me letër njoftimin personal me nr. _____ që më poshtë do të quhet "QIRAMARRËSI".

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me propozimin nr. 393/1, datë 21.1.2020, të Ministrisë së Mbrojtjes, mbështetur në vendimin nr.54, datë 5.2.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore", të ndryshuar, pas konkurimit të zhvilluar më datë 26.02.2020, në zbatim të urdhrit nr.33 date 5.2.2020 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, shpalli fitues subjektin "CEREN Ismet Shehu" SHPK, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.____, datë ___/____/2020 "Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës dhe shoqërisë "CEREN Ismet Shehu" SHPK, si qiramarrës për pasurinë shtetërore me emërtimin "Ish-reparti ushtarak nr.3031", me sipërfaqe të përgjithshme 40.000 m^2, nga e cila sipërfaqe nën objekt 1456.4 m^2, 10 tunele me sipërfaqe të përgjithshme 1.000 m^2 dhe sipërfaqe funksionale 37.543.6 m^2, me vendndodhje në Surrel - Tiranë, me nr.pasurie 207/30, vol 9, fq 125, zona kadastrale 3550 në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes Tiranë, dhe bazuar në nenet 801-825 të Kodit Civil, si dhe kërkesës së subjektit "CEREN Ismet Shehu" SHPK, së bashku me "Qiramarrësin", palët bien dakord të hartojnë këtë kontratë, me kushtet si më poshtë:

Neni 1
Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate, është dhënia me qira e pasurisë shtetërore me emërtimin "Ish-reparti ushtarak nr.3031", me sipërfaqe të përgjithshme 40.000 m^2, nga e cila sipërfaqe nën objekt 1456.4 m^2, 10 tunele me sipërfaqe të përgjithshme 1.000 m^2 dhe sipërfaqe funksionale 37.543.6 m^2, me vendndodhje në Surrel - Tiranë, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, Tiranë, sipas vërtetimit të

pronësisë nr. me nr.pasurie 207/30, vol 9, fq 125, zona kadastrale 3550 dhe genplanit që i bashkëlidhet kontratës.

Neni 2
Qëllimi i përdorimit

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm i objektit të përcaktuar në nenin 1, për të zhvilluar veprimtari për në fushën e agrobiznesit për grumbullimin, përpunimin e produkteve bujqësore- blegtorale nga fermerët e zonës përreth, duke investuar rreth 100 262 262 lekë pa TVSH dhe punësuar minimalisht 50 punonjës në total.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhe 20 (njëzetë) vjet dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Neni 4
Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit

4.1 "Qiradhënësi", nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes (Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura) si njësia që ka në administrim pasurinë shtetërore, dorëzon brenda një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, pronën e përcaktuar në nenin 1 të saj, të lirë për t'u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet proces-verbali i dorëzimit të objektit që jepet me qira i shoqëruar me foto, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.

4.2 "Qiradhënësi" ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e "Qiramarrësit".

4.3 "Qiradhënësi" ka të drejtë që, në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së kontratës, nëpërmjet njësisë monitoruese të kontratës së qirasë, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura Tiranë, të monitorojë kontratën për verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në të.

4.4 "Qiradhënësi" është i detyruar të garantojë "Qiramarrësin" për gëzimin e qetë të sendit, objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrenë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë.

4.5 "Qiradhënësi" ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur "Qiramarrësi" shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 30 ditë përpara me shkrim.

4.6 "Qiradhënësi" nuk është i detyruar të garantojë "Qiramarrësin" nga shqetësimet e të tretëve që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.

Neni 5
Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

5.1 "Qiramarrësi" ka të drejtë që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

5.2 "Qiramarrësi" ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e parashikuar në nenin 2, në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar.

5.3 "Qiramarrësi" detyrohet që në pasurinë e marrë me qira, të realizojë aktivitetin sipas nenit 2 të kësaj kontrate, duke investuar sipas fazave dhe vlerave të shprehura në planin biznesin e paraqitur në komisionin e vlerësimit të dokumenteve.

5.4 "Qiramarrësi" detyrohet të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë objektin e kontratës së qirasë.

5.5 "Qiramarrësi" detyrohet të përballojë me shpenzimet e tij, detyrimet që lidhen me dëmet e shkaktuara eventualisht palëve të treta.

5.6 "Qiramarrësi" detyrohet të sigurojë objektin e kontratës së qirasë, nëpërmjet policës së sigurimit.

5.7 "Qiramarrësi", në funksion të zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate do të investojë për të ngritur aty një qendër biznesi multifunksionale për grumbullimin, përpunimin e produkteve bujqësore- blegtorale nga fermerët e zonës përreth. Qendra e biznesit do të jetë dhe në shërbim të nevojave të fermerëve për trajtimin e produkteve të prodhuara në fermat e tyre, si dhe duke punësuar pjesën më të madhe të stafit të tij nga komuniteti lokal.

Totali i vlerës së investimeve në pasurinë shtetërore, sipas planbiznesit shkon rreth 100 262 262 lekë pa TVSH, dhe do të përfundojë brenda 36 muajve nga data e marrjes në dorëzim të objektit dhe nxjerrjeve të lejeve përkatëse për punimet.

Sipas plan biznesit të paraqitur, në konkurrim ky investim do të realizohet si vijon:

- investime në infrastrukturë prodhuese për rikonstruksionin komplet të godinave egzistuese, duke i kthyer në magazinat e grumbullimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore, si dhe në dhoma frigoriferike, menca dhe fjetinë për punonjësit rreth 75.686.800 lekë.
- investime në në linjën për pastrimin, selektimin, kalibrimin, paketimin e perimeve 12.150 200 lekë.
- investime në linjën e përpunimit të produkteve bujqësore e shtazore, si dhe investimin në përshtatjen e tuneleve në magazina dhe dhoma të degustimit të nënprodukteve të përpunuara, brenda kompleksit të agrobiznesit 12.426.262 lekë

Pavarësisht parashikimeve të realizimit si më sipër, monitorimi dhe përllogaritjet e afateve të realizimeve të investimeve të parashikuara transferohen në kohë gjithmonë pas datës së lejeve përkatëse të nevojshme për punime, ngritjen e aktivitetit dhe vënien në jetë të tij.

"Qiramarrësit" nuk i lejohet që zërat për punimet që do të kryejë në pasurinë e dhënë me qira sipas parashikimeve të sipërcituara të konsistojnë në prishjen në themel të objekteve, për t'i ndërtuar ato nga e para.

5.8 "Qiramarrësi", sipas parashikimit për punësimin të shprehur në plan biznesin e paraqitur në konkurrim, në përfundim të vitit të parë të investimit do të punësoj 10 punonjës të rinj, në përfundim të vitit të dytë të investimit do të punësoj dhe 10 punonjës të rinj, në përfundim të vitit të tretë të investimit do të punësoj dhe 10 punonjës të rinj, në përfundim të vitit të katërt të investimit do të punësoj dhe 10 punonjës të rinj, në përfundim të vitit të pestë të investimit do të jenë të punësuar dhe 10 punonjës të rinj.

Në total numri i të punësuarve, brenda 5 viteve nga data e marrjes në dorëzim të objektit dhe nxjerrjeve të lejeve përkatëse do të jetë minimalisht 50 punonjës.

Pavarësisht parashikimeve të realizimit si më sipër, monitorimi dhe përllogaritjet e afateve të realizimeve të punësimit të parashikuar transferohen në kohë gjithmonë pas datës së lejeve përkatëse të nevojshme për punime, ngritjen e aktivitetit dhe vënien në jetë të tij.

"Qiramarrësi detyrohet të zbatojë legjislacionin në fuqi "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".

5.9 "Qiramarrësi", në funksion të qëllimit sipas nenit 2 dhe zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër sipas neneve 5.7 dhe 5.8, detyrohet që të pajiset me Leje ndërtimi dhe Leje mjedisore nga organet kompetente.

5.10 "Qiramarrësi" detyrohet që, para përfundimit të vitit të pestë të përdorimit të objektit me qira sipas kësaj kontrate, të paraqesë para "Qiradhënësit" shtesën e plan biznesit për treguesit e periudhës në vijim, brenda objektit të kontratës dhe pa ulur treguesit e shprehur në pikat 5.7 dhe 5.8 të kësaj kontrate.

5.11 "Qiramarrësi" detyrohet të paraqesë tek "Qiradhënësi" në fillim të çdo viti, relacion me shkrim lidhur me vlerat e investimeve, të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të subjektit, shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar, vërtetuar me çdo dokumentacion të vlefshëm, si dhe vërtetimin nga institucionet shtetërore përkatëse për numrin e të punësuarve në objektin e marrë me qira.

5.12 "Qiramarrësi" detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.

5.13 "Qiramarrësi" në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa dëmtuar atë. "Qiradhënësi" nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga "Qiramarrësi".

5.14 Në ngarkim të "Qiramarrësit" janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

5.15 "Qiramarrësit" nuk i lejohet, që pronën e dhënë me qira ta japë me nën qira ose t'ia kalojë kontratën një tjetri.

5.16 "Qiramarrësi", në funksion të qëllimit dhe zhvillimit të aktivitetit sipas nenit 2 të kësaj kontrate, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër, sipas neneve 5.7 dhe 5.8, detyrohet që, të pajiset me lejet ose autorizimet përkatëse nga organet kompetente të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

5.17 "Qiramarrësi" në asnjë rast nuk mund ta rëndojë me barrë, pronën objekt të kësaj kontrate

Neni 6
Pagesa e qirasë

6.1"Qiramarrësi" detyrohet t'i paguajë "Qiradhënësit" detyrimin e kontratës, në vlerën 1 (një) euro.

Pagesa simbolike bëhet para se të firmoset kontrata, sipas faturës të lëshuar nga "Qiradhënësi".

6.2 Para nënshkrimit të kontratës "Qiramarrësi" ka paguar garancinë e kontratës, në vlerën 2 005 245 (dy milion e pesë mijë e dyqindedyzetepesë) lekë, sipas faturës së lëshuar nga "Qiradhënësi", e cila qëndron e ngurtësuar, në llogarinë përkatëse në buxhetin e shtetit, deri në përfundim të investimit të shprehur në nenin 5.7 të kësaj kontrate.

6.3 Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penalitete ose gjoba, "Qiramarrësi" do të likuidojë vlerat e krijuara në llogarinë e "Qiradhënësit" sipas faturës së lëshuar nga ky i fundit.

Neni 7
Penalitetet

7.1 Në rastin kur "Qiramarrësi", sipas përcaktimeve në pikën 5.7, të kësaj kontrate, nuk realizon vlerën e investimit, do të penalizohet me gjobë, në masën 10 për qind të vlerës së investimit të parealizuar. Nëse, pas 6 muajve, investimi vazhdon të mos realizohet, "Qiradhënësi" zgjidh kontratën dhe gjobit "Qiramarrësin" me vlerën e garancisë së ngurtësuar në momentin e lidhjes së kësaj marrëveshje kontraktore.

7.2 Në rastin kur, "Qiramarrësi", nuk ka realizuar nivelin e punësimit të përcaktuar në pikën 5.8, të kësaj kontrate, penalizohet me gjobë, në masën 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë për çdo vend pune mesatar vjetor të pahapur.

Neni 8
Zgjidhja e kontratës

8.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 3 të kësaj kontrate.

8.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

a) në marrëveshje midis palëve;

b) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore.

c) kur "Qiramarrësi" shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 dhe 6 të kësaj kontrate.

d) kur "Qiramarrësi" ndryshon destinacionin për të cilin është lidhur kontrata.

e) kur prona nevojitet për interes publik.

f) kur prona kalon në procedurë privatizimi.

8.3 Kontrata pushon automatikisht së vepruari, 30 ditë pas njoftimit me shkrim të "Qiradhënësit" për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas pikës 8.2 të saj dhe nëse "Qiramarrësi" nuk ka reaguar me shkrim.

Neni 9
Përgjegjësitë e palëve

9.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.

9.2 Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përfundim të investimit, pas relacionit të paraqitur nga "Qiramarrësi", sipas pikave 5.7, dhe 5.8 dhe 5.9 të kësaj kontrate, palët janë të detyruar të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta ndërmjet administratorit të pasurisë, për nivelin e investimeve dhe punësimit të realizuara, sipas vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare të subjektit, shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar.

9.3 Palët janë të detyruar që çdo vit të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta për realizimin e kushteve të kontratës, në nivelin e punësimit, në nivelin e investimit dhe shlyerjen e penaliteteve ose gjobave (në rastet kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate.

9.4 Me "Forcë Madhore" do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si tërmetet, përmbytjet, lufta. Në këto raste palët janë të detyruara të njoftojnë njëra tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për aq kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.

9.5 "Qiramarrësi" përjashtohet nga detyrimet për kohën e vazhdimit të Forcës Madhore dhe mos kryerjes së aktivitetit për këtë shkak. Kjo periudhe do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve.

Neni 10
Dispozitat e fundit

10.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do t'i referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

10.2 Pjesë të kësaj kontrate janë plan biznesi i paraqitur para komisionit të konkurrimit dhe proces verbali i marrjes në dorëzimi të objektit, sipas kontratës së qirasë.

10.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të zgjidhen

Me mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.

10.4 Në çdo rast të kalimit të mosmarrëveshjeve, të lindura mes palëve në juridiksion gjyqësor, autorizohet njësia administruese dhe monitoruese e kontratës për ndjekjen e procedurës gjyqësore.

10.5 Kjo kontratë qiraje është e vlefshme deri në çastin, që prona publike e dhënë me qira privatizohet sipas akteve ligjore në fuqi.

Neni 11

11.1 Brenda një muaji nga nënshkrimi i saj, kontrata duhet të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

11.2 Shpenzimet noteriale të kësaj kontrate i ngarkohen "Qiramarrësit".

11.3 Kjo kontratë është formuluar në shtatë kopje origjinale. Pasi ju lexua palëve, u kuptua, u pranua prej tyre, si dhe u nënshkrua para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Ndërsa, unë noter _____, në bazë te nenit 801 e vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë si të rregullt.

QIRADHËNËSI Ministria e Financave dhe Ekonomisë Përfaqësuar nga	QIRAMARRËSI Shoqëria "CEREN Ismet Shehu" SHPK Përfaqësuar nga

VENDIM
Nr. 330, datë 22.4.2020

PËR KRIJIMIN E BAZËS TË TË DHËNAVE SHTETËRORE "SISTEMI I DEKLARIMIT TË PASURISË DHE KONFLIKTIT TË INTERESIT – EACIDS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) të bazës të të dhënave shtetërore "Sistemi i Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit – EACIDS", i cili do të aksesohet në faqen zyrtare të internetit të Inspektoratit.

2. ILDKPKI-ja është përgjegjëse për krijimin, mbajtjen, administrimin e bazës të të dhënave "Sistemi i Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit – EACIDS", dhe për ndërveprimin e përmbajtjes së tij me bazat e tjera të informacionit.

3. Të dhënat që përmban "Sistemi i Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit – EACIDS" ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore konsiderohen të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti në deklaratat e interesave private.

b) Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat e marra nga ndërveprimi me baza të tjera të të dhënave të informacionit pranë institucioneve, si më poshtë vijon:

i. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC);

ii. Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB);

iii. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT);

iv. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR);

v. Njësia e Trajtimit të Koncesioneve/PPP (ATRAKO);

vi. Agjencia e Prokurimit Publik (APP);

vii. Sistemi Informatik për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (HRMIS);

viii. Thesari;

ix. Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS);

x. Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK);

xi. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD);

xii. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE);

xiii. Bankat, institucionet financiare jobankare, përfshirë edhe fondet e investimeve dhe të pensioneve;

xiv. Çdo bazë tjetër të dhënash që mund të ndërveprojë me "Sistemin e Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit – EACIDS".

4. Dhënës të informacionit për këtë bazë të dhënash janë, si më poshtë vijon:

a) Personat që janë subjekt i deklarimit, sipas ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve finaciare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", të ndryshuar;

b) Institucionet:

i. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI);

ii. Bankat, institucionet financiare jobankare, përfshirë edhe fondet e investimeve dhe të pensioneve;

iii. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Qendra Kombëtare e Biznesit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

iv. Institucione të tjera shtetërore, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

5. Niveli i aksesimit në sistemin elektronik dhe bazën e të dhënave të EACIDS është, si më poshtë vijon:

a) Individët që janë subjekt deklarimi dhe personat e lidhur me ta kanë akses në pjesën e sistemit, nga ku mund të kryejnë deklarimin, si dhe të shtojnë e të lexojnë vetëm të dhënat që kanë lidhje me ta, si dhe të modifikojnë ose të fshijnë për sa kohë nuk kanë aprovuar versionin përfundimtar të deklarimit.

b) ILDKPKI-ja ka akses si administrator dhe përdorues në EACIDS. Niveli i aksesimit, funksionet dhe të drejtat për përdoruesit e sistemit janë në përputhje me pozicionin e punës dhe përcaktohen në rregulloren e "Sistemit të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë/Interesave Private dhe Konfliktit të Interesave", të miratuar nga ILDKPKI-ja, në zbatim të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore".

c) Çdo person i interesuar, duke mos u kufizuar, individë, person juridik, privatë ose publikë, masmedia-n, shoqërinë civile, i cili ka akses për të lexuar ose marrë informacionin e publikuar në përputhje me kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

6. Ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave shtetërore dhe procedurat e realizimit të ndërveprimit përcaktohen në rregulloren e "Sistemit të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë/Interesave Private dhe Konfliktit të Interesave", të miratuar nga ILDKPKI-ja, në zbatim të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore".

7. Funksionet dhe të drejtat e secilit përdorues janë në përputhje me pozicionin e punës dhe të përcaktuara në rregulloren e "Sistemit të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë/Interesave Private dhe Konfliktit të Interesave", të miratuar nga ILDKPKI-ja, në zbatim të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore".

8. Të gjitha ndryshimet në arkitekturën software dhe hardware të EACIDS-së, të cilat mund të ndodhin në varësi të nevojave të institucionit dhe të praktikave evropiane e ndërkombëtare, bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

9. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave është administratori i vetëm dhe përgjegjës i drejtpërdrejtë për strukturën e bazës të të dhënave të "Sistemit të Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit – EACIDS", në anën funksionale dhe operacionale.

10. Ngarkohet Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 331, datë 22.4.2020

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.649, DATË 14.9.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E LISTËS SË SPECIALITETEVE, NËNSPECIALITETEVE APO SPECIALITETEVE PLOTËSUESE PËR PROFESIONET E RREGULLUARA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13, të ligjit nr.10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr.40/2016, "Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.649, datë 14.9.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në shtojcën 1 "Lista e specialiteteve, nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara", pas ndarjes XI shtohet ndarja XII, me këtë përmbajtje:

"XII. Profesioni i psikologut (Diplomë e ciklit të dytë ose ekuivalente me të).".

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr.332, datë 22.4.2020

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURSIT "TOKË BUJQËSORE" NË "TOKË URBANE", TRUALL, PËR SIPËRFAQEN NDËRTIMORE SIPAS LIDHJES NR.1, TË PASURISË ME NUMËR 106/23, ZONA KADASTRALE 1936, BASHKIA DROPULL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr.8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, për sipërfaqen ndërtimore prej 150 m2, të pasurisë me numër 106/23, zona kadastrale 1936, fshati Haskovë, njësia administrative Dropull i Poshtëm, Bashkia Dropull, sipas certifikatës të pasurisë, hartës treguese dhe lidhjes nr.1, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, Qarku Gjirokastër, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit, nga "tokë bujqësore" në "tokë urbane", për sipërfaqen ndërtimore sipas lidhjes nr.1, të pasurisë me numër 106/23, zona kadastrale 1936, fshati Haskovë, njësia administrative Dropull i Poshtëm, Bashkia Dropull.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Qarkut Gjirokastër dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Gjirokastër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 1601268

PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit GJIROKASTER Zona Kadastrale Nr. 1936

Numri i Pasurisë 106/23 Volumi 3 Faqe 203

Adresa e Pasurisë HASKOVE GJIROKASTER

Lloji i Pasurisë ARE

Sipërfaqja Totale 2350 m²

Nga kjo : Sa Truall — Nga kjo : Sa Ndërtesa —

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes — %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
DHIMITRI	NIKOLLA	QIRUSHI	I	HASKOVE GJIROKASTER

- është pronar i NO PAS. NR 106/23
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart —
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi —
- kufizimet e pasurisë janë : V 167, L 106/3, J 106/20, P 106/1

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 13.9.2017 Nr. 23499

Data e lëshimit të çertifikatës 12.04.2018

Lëshuesi i çertifikatës REGJISTRUESI (FLORJAN TAÇI)


HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT
(fragment)
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME
A-IDENTIFIKIMI PASURISE
ZONA KADASTRALE 1936 NR PASURISE 106/23 VOL 3 FQ 2
INDEKSI I HARTES IC-34-137(247-D) SHKALLA 1:250
ADRESA E PASURISE (RRETHI) GJIROKASTER
RRUG PG SH K AP
GJIROKASTER
REGJISTRUES
FLORJAN TAÇI
B-KUFIZIMET
V. 167.
L. 106/3
J. 106/20
P. 106/1
C-PRONARI
DHIMITRI QIRKO
SIPERFAQJA: 2350 m²
NDERTUAR: — m²
DATA 12.04.2018
HARTOGRAF: THANAS QIRKO



LIDHJA NR.1

Nr. rendor	Qarku	Bashkia	Zona kadastrale	Adresa e pasurisë	Numri i pasurisë	Sipërfaqja m^2	Sipërfaqja ndërtimore m^2	Emërtimi i strukturës
1	Gjirokastër	Dropull	1936	Haskovë	106/23	2350	150	Magazinë grumbullimi produktesh bujqësore

VENDIM
Nr. 333, datë 22.4.2020

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT ME SHKËMBIM NOTASH TË MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR SHTESËN E FINANCIMIT PËR PROJEKTIN E BURIMEVE UJORE DHE UJITJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr.43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e ndryshimit me shkëmbim notash të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e burimeve ujore dhe ujitjes, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Banka Botërore
BERZH-IDA GRUPI I BANKËS BOTËRORE
ZYRA E GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE

Praterstrasse 31/21
Vienna, Austria, 1020
19 shkurt 2020

SH. Saj Anila Denaj
Ministre
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

E nderuar Ministre,

Shqipëria: Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes
(Numri i Huasë së IBRD-së-88170)
Shtyrja e Datës së Mbylljes)

I referohemi Marrëveshjes së Huasë (Marrëveshja e Huasë) së datës 19 mars 2018 ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka) për projektin e Burimeve Ujore dhe Ujitjes (Projekti) dhe Letrës Suaj datë 31 dhjetor 2019, ku kërkohet që Banka të shtyjë Datën e Mbylljes të Huasë të cituar më lart, të parashikuar sipas Marrëveshjes së Huasë.

Kam kënaqësinë t'iu informoj se Banka ka vendposur datën 31 maj 2021 si datë të mëvonshme për qëllime të skedulit 2, Seksioni IIIB.2 të Marrëveshjes së Huasë.

Me respekt
Nënshkrimi
Lada Strelkova

Drejtore e Komanduar Rajonale, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

Në vëmendje të:

Sh. së Tij Bledi Çuçi, Ministër, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Z. Elton Haxhi, Zv.Ministër i Financave dhe Ekonomisë
Z. Enea Hoti, Sekretar i Përgjithshëm, Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Z. Erfan Tarelli, Drejtor i Përgjithshëm i Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Politikave të Zhvillimit Rural, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Z. Altin Skëndo, Menaxher i Projektit WRIP, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Znj. Greta Lubonja, Drejtore e Përgjithshme e Sekretariatit Teknik të Ujit, Këshilli Kombëtar i Ujit, Këshilli i Ministrave
Znj. Majlinda Dhuka, Zv.Sekretare e Përgjithshme dhe Drejtore e Përgjithshme e Departamentit për Zhvillim dhe Qeverisjen e Mirë
Z.Thomas Nystrom, Zyrtar Programi, Agjencia Suedeze e Zhvillimit Ndërkombëtar
Z.Patrizio Pagano, Drejtor Ekzekutiv, Banka Botërore

Tel:+43(1)2170 782
Faks: +43(1)2170 701

VENDIM
Nr. 334, datë 22.4.2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.599, DATË 23.7.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PAGESAVE QË KRYHEN NË AUTORITETIN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE, PËR CAKTIMIN DHE PËRDORIMIN E FREKUENCAVE, TË NUMRAVE DHE TË SERIVE NUMERIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 3, dhe 119, pika 2, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr.1, të vendimit nr.599, datë 23.7.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në tabelën nr.1, të pikës 2.1 "Shërbimi publik i lëvizshëm tokësor", shtohet numri rendor 10, me të dhënat, si më poshtë vijon:

Nr.	Brezat e frekuencave (MHz)	Njësia e matjes së brezit	Pagesa vjetore në lekë
10.	(1452-1492)	1*5 MHz	800.000

b) Nënpika 2, e pikës 2.5, "Shërbime satelitore", ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Pagesa vjetore, kur sistemi satelitor i lëvizshëm MSS/stacioni satelitor tokësor fiks, pavarësisht vendndodhjes së tij, përdor një frekuencë pune të ndryshme nga ato të brezave të frekuencave të dhëna më lart në pikën 1, është në varësi të brezit të frekuencave, gjerësisë së spektrit të përdorur, fuqisë EIRP të transmetimit dhe llogaritet sipas tabelës nr.7.".

c) Në fillim të tabelës nr.7 shtohen pagesat sipas përcaktimeve, si më poshtë vijon:

Brezi frekuencës (GHz)	Gjerësia e brezit (MHz)	EIRP<50 dBW	50 dBW≤ EIRP ≤ 75dBW	EIRP>75dBW
<3	BW<0.5	200 000	250 000	300 000
	0.5 ≤ BW<2	250 000	300 000	350 000
	2 ≤ BW<11	300 000	350 000	400 000
	11≤ BW <40	350 000	400 000	450 000
	40 ≤ BW ≤ 80	400 000	450 000	500 000
	BW> 80	400 000+ (BW-80) x 3.000	400 000+ (BW — 80) x 3.000	420 000 +(BW – 80) x3.000

2. Ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 335, datë 22.4.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.967, DATË 25.10.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË KOMITETIT TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të ligjit nr.10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.967, datë 25.10.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve kryesohet nga zëvendësministri që mbulon çështjet e mjedisit dhe në përbërje ka këta anëtarë:

a) Zëvendësministrin që mbulon çështjet e pushtetit vendor;

b) Zëvendësministrin që mbulon çështjet e mbrojtjes dhe të emergjencave civile;

c) Zëvendësministrin që mbulon financat dhe buxhetin;

ç) Zëvendësministrin që mbulon çështjet e infrastrukturës së mbetjeve;

d) Zëvendësministrin që mbulon çështjet e arsimit;

dh) Zëvendësministrin që mbulon çështjet e drejtësisë;

e) Zëvendësministrin që mbulon fushën e shëndetësisë;

ë) Zëvendësministrin që mbulon çështjet e integrimit evropian;

g) Zëvendësministrin që mbulon çështjet e bujqësisë;

gj) Përfaqësuesin e kabinetit të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.".

2. Pas pikës 9 shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje:

"9/1 Mbledhjet e Komitetit organizohen dhe asistohen nga sekretariati teknik, rol të cilin e kryen sektori teknik për mbetjet pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin.".

3. Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"10. Në mbledhjen e parë të çdo viti, Komiteti miraton programin e punës. Në rastet kur në Komitet paraqiten çështje të reja për diskutim, që lidhen me menaxhimin e integruar të mbetjeve apo me situatat emergjente mjedisore të krijuara, kryetari propozon rishikimin e programit dhe ia paraqet për miratim Komitetit.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr.339, datë 22.4.2020

PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË DREJTORIT EKZEKUTIV TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të ligjit nr.10233, datë 11.2.2010, "Për Autoritetin e Aviacionit Civil", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Krislen Keri, drejtor Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 340, datë 22.4.2020

PËR EMËRIMIN E DREJTORIT EKZEKUTIV TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr.10233, datë 11.2.2010, "Për Autoritetin e Aviacionit Civil", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Edlira Kraja emërohet drejtor Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Korrigjim gabimi material

Në vendimin nr.342, datë 25.4.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për një ndryshim në vendimin nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore"", botuar në Fletoren Zyrtare nr.75/2020, faqe 4248, bëhet korrigjimi si më poshtë :

Në pikën 1, data 27.11.2019 zëvendësohet me 24.3.2020.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 392 lekë